



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio nr. 479/2023 lidhur me

ndikimin e peshës së çantave tek fëmijët e shkollave fillore (cikli 1-5), funksionalizimin e dollapëve në shkolla

Drejtuar:

- Znj. Arbërie Nagavci, Ministre - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
- Z. Bashkim Ramosaj, kryetar, Komuna e Deçanit
- Z. Bexhet Xheladini, kryetar, Komuna e Dragashit
- Z. Burim Berisha, kryetar, Komuna e Fushë Kosovës
- Z. Agim Aliu, kryetar, Komuna e Ferizajt
- Znj. Ljiljana Šubarić, kryetare, Komuna e Graçanicës
- Z. Mehmet Ballazhi, kryetar, Komuna e Hanit të Elezit
- Z. Ilir Ferati, kryetar, Komuna e Istogut
- Z. Besim Ilazi, kryetar, Komuna e Kaçanikut
- Z. Kadri Rahimaj, kryetar, Komuna e Kamenicës
- Z. Zenun Elezaj, kryetar, Komuna e Klinës
- Z. Vladan Bogdanović, kryetar, Komuna e Klllokotit
- Z. Imri Ahmeti, kryetar, Komuna e Lipjanit
- Z. Ekrem Kastrati, kryetar, Komuna e Malishevës
- Z. Abdülhadi Krasniç, kryetar, Komuna e Mamushës
- Z. Bedri Hamza, kryetar, Komuna e Mitrovicës së Jugut
- Z. Saša Milošević, kryetar, Komuna e Novobërdës
- Z. Xhafer Gashi, kryetar, Komuna e Obiliqit

- Z. Dragan Petković, kryetar, Komuna e Parteshit
- Z. Gazmend Muhaxheri, kryetar, Komuna e Pejës
- Z. Shpejtim Bulliqi, kryetar, Komuna e Podujevës
- Z. Përparim Rama, kryetar, Komuna e Prishtinës
- Z. Shaqir Totaj, kryetar, Komuna e Prizrenit
- Z. Smajl Latifi, kryetar, Komuna e Rahovecit
- Znj. Katarina Ristić-Ilić, kryetare, Komuna e Ranillugut
- Z. Dalibor Jevtić, kryetar, Komuna e Shtërpçës
- Z. Qemajl Aliu, kryetar, Komuna e Shtimes
- Z. Fadil Nura, kryetar, Komuna e Skenderajt
- Z. Bali Muharremaj, kryetar, Komuna e Therandës
- Z. Sokol Haliti, kryetar, Komuna e Vitisë
- Z. Ferit Idrizi, kryetar, Komuna e Vushtrisë
- Z. Erden Atiq, kryetar, Komuna e Mitrovicës së Veriut
- Z. Izmir Zeqiri, kryetar, Komuna e Zubin Potokut
- Z. Ilir Peci, kryetar, Komuna e Zveçanit
- Z. Lulzim Hetemi, kryetar, Komuna e Leposaviqit

Kopje:

- Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 27 mars 2025

Qëllimi i raportit

Qëllimi dhe fokusi i këtij raporti është analizimi dhe ofrimi i informacioneve mbi peshën e çantës shkollore, ndikimin negativ që mbingarkesa e çantës ka te nxënësit, veçanërisht te ata të ciklit fillor. Raporti gjithashtu synon të shikojë se si ndikimi i çantave të rënda ndikon në të drejtën e fëmijëve për të pasur një shëndet optimal dhe për të jetuar në kushte që promovojnë zhvillimin e tyre të plotë, dhe si autoritetet duke pasur parasysh interesin më të mirë të fëmijëve, duhet të kujdesen në mirëqenien e tyre. .

Raporti thekson rëndësinë e funksionalizimit të dollapëve në shkolla si një zgjidhje praktike për të zvogëluar peshën ditore që fëmijët duhet të mbajnë me vete, si dhe rekomandon që institucionet arsimore, në bashkëpunim me komunat dhe Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, të sigurojnë infrastrukturën e nevojshme për vendosjen dhe mirëmbajtjen e dollapëve, duke krijuar një mjedis më të shëndetshëm dhe më të përshtatshëm për nxënësit. Në këtë mënyrë, raporti shërben si një instrument për të inkurajuar politikatat arsimore që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e fëmijëve për arsim cilësor dhe kushte të favorshme mësimore.

Kompetencat e Avokatit të Popullit

1. Në përputhje me nenin 132 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta): *“Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.”* Kushtetuta më tutje në nenin 135, paragrafi 3, parasheh: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
2. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, Avokati i Popullit, ndër të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - *“Për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit (neni 16, paragrafi 1);*
 - *të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (neni 16, paragrafi 4);*
 - *Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave (neni 16, paragrafi 8);*

- *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, par. 1, nënparagrafi. 1.2);*
- *t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.”* (neni 18, par. 1, nënparagrafi. 6).

Veprimet e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP)

3. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 4¹, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 27 janar 2023 ka hapur rast ex - officio lidhur me mbipeshën e çantës shkollore të nxënësve të ciklit fillor dhe çështjet shëndetësore – (pasoja fiziko-terapeutike) që i shkakton mbingarkesa fizike.
4. Gjatë muajve mars dhe prill 2024, Avokati i Popullit ka kërkuar përgjigje në disa pyetje konkrete, nga komunat e Kosovës² në mënyrë që t'i merrte informatat e duhura dhe të shihte pasqyrën e qartë lidhur me rastin:
 - *“Komuna që udhëhiqni ju, sa shkolla të ciklit fillor 1-5, ka të pajisura me dollapë funksionale për vendosjen e librave të nxënësve dhe sa të tjera jo?*
 - *Komuna që udhëhiqni ju a ka hapësira të mjaftueshme nëpër shkollat e komunës, për vendosjen e dollapëve?*
 - *Mesataren e distancës rrugore që fëmijët e ndjekin këmbë nga shkolla në shtëpi dhe anasjelltas?*
 - *Na e ofroni çdo informatë apo dokument tjetër relevant, që konsideroni se mund t'i ndihmojë dhe plotësojë të dhënat për çështjen në fjalë.”*
5. Gjatë muajve mars, prill, maj dhe qershor 2024, Institucioni i Avokatit të Popullit, për informatat e kërkuara lidhur me çështjen, ka marrë përgjigje nga këto komuna: Prishtinë, Hani i Elezit, Mitrovicë e Jugut, Podujevë, Therandë, Junik, Viti, Rahovec, Gjakovë, Shtime, Dragash, Klinë, Graçanicë.
6. Meqenëse jo të gjitha komunat janë përgjigjur në kërkesën e Avokatit të Popullit për informata lidhur me çështjen, në qershor të vitit 2023 Avokati i Popullit u ka dërguar letër përsëritëse komunave që nuk janë përgjigjur³, duke ua rikujtuar nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës⁴, dhe nenet 18 dhe 25 të Ligjit për Avokatin e Popullit, që u bëjnë thirrje

¹Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex-officio), nëse nga konstatimet, nga dëshmitë dhe nga faktet e paraqitura me parashtrësë, ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut, të përcaktuara me Kushtetutë, me ligje dhe me akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

² Komunat: Deçan, Dragash, Drenas, Fushë Kosovë, Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Graçanicë, Hani i Elezit, Istog, Junik, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Klokot, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtërpce, Shtime, Skenderaj, Therandë, Viti, Vushtri, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq.

³ Komunat: Deçan, Drenas, Fushë Kosovë, Ferizaj, Gjilan, Istog, Kaçanik, Kamenicë, Klokot, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Pejë, Prizren, Ranillug, Shtërpce, Skenderaj, Vushtri, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq.

⁴ Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'iu përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'ia paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin.

autoriteteve publike t'u përgjigjen kërkesave të IAP-së për sigurimin e informacioneve, dokumenteve dhe dosjeve brenda kohës së arsyeshme.

7. Avokati i Popullit, deri në publikimin e këtij raporti, nuk pranoi përgjigje nga 12 komuna: Fushë Kosovë, Istog, Kamenicë, Malishevë, Novobërdë, Partesh, Pejë, Ranillug, Skenderaj, Vushtrri, Zubin Potok, Leposaviq. Në këtë rast këto komuna kanë dështuar të përgjigjeshin në kërkesat e Avokatit të Popullit duke shkelur dispozitat përkatëse kushtetuese dhe Ligjin për Avokatin e Popullit. Sidoqoftë, kjo nuk e pengon Avokatin e Popullit t'i japë konkluzionet dhe rekomandimet lidhur me çështjen.⁵

Instrumentet ligjore të zbatueshme

8. Legjislacioni në Republikën e Kosovës përfshin një numër të madh aktesh normative-juridike, të cilat synojnë të sigurojnë mbrojtjen e veçantë për fëmijë. Fillimisht Kushtetuta mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke përfshirë këtu edhe të drejtat e fëmijës. Zbatimi dhe realizimi në praktikë i këtyre të drejtave është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës. Kushtetuta shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha institucioneve që t'i respektojnë liritë dhe të drejtat e njeriut⁶, dhe ky parim vlen për të gjithë, përfshirë edhe institucionet përkatëse komunale, duke i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për mbrojtjen e interesave të fëmijës. Për më tepër, Kushtetuta në nenin 50 përcakton obligimet e të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës për t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e jetës së fëmijës, mirëqenien, mbrojtjen nga abuzimet, nga keqpërdorimet, si dhe mbrojtje të tjera në të gjitha fushat e jetës, që janë në interes të mirëqenies së tij/saj.
9. Gjithashtu Kushtetuta në nenin 22 (Zbatimi i drejtëpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare) ka paraparë: *“të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtëpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike.”*
10. Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF), në nenin 3 përcakton: *“Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese”.*
11. KDF po ashtu në nenin 24 përcakton se: *“1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë dhe për të përfitur nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes dhe riaftësimin e shëndetit. Shtetet Palë përpiqen të sigurojnë që asnjë fëmijë të mos i mohohet e drejta për të pasur këto shërbime të kujdesit shëndetësor.”.* Më tej, neni 19 i KDF thekson si në vijim: *“1. Shtetet Palë marrin të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës*

⁵ Ligji për Avokatin e Popullit, neni 24, paragrafi 4: *“Refuzimi apo dështimi për t'u përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit konsiderohet pengim i punës së Avokatit të Popullit. Kjo nuk e pengon Avokatin e Popullit për të nxjerrë konkluzionet dhe rekomandimet e tij.”*

⁶ Kushtetuta, neni 21: *“1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. 2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë. 3. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve. 4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”*

nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.”

12. Për më tepër, Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës (në tekstin e mëtejshëm: LMF)⁷, në nenin 1 ka përcaktuar qëllimin e tij: “[...] 1.2. të mbrojtë fëmijën nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimit, keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo ndonjë forme tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës; 1.3. të garantojë dhe sigurojë përgjegjësitë e prindërve, familjes, organit të kujdestarisë, shoqërisë dhe të shtetit në kujdesin, mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijës bazuar në interesin më të mirë të fëmijës; [...]”
13. Ndërsa Ligji nr. 04/l-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (LAPRK), në nenin 5 - Detyrat e Ministrisë ka përcaktuar: “[...] 7.1.hartimi dhe monitorimi i zbatimit të politikave, standardeve dhe normave për hapësirën shkollore; 7.2.ofrimin e ndihmës teknike për komunat në planifikimin dhe dizajnimin e objekteve arsimore dhe aftësuese.
14. Gjithashtu ky ligj në nenin 7 – Kompetencat e komunës ka përcaktuar: “[...] 3.3. sigurimin e një ambienti të shëndetshëm, duke përfshirë ujin e pijshëm, kushtet higjieniko-sanitare, shërbimin shëndetësor, si dhe ambient të sigurt për nxënësit dhe personelin duke përfshirë sigurimin e shërbimeve të sigurta dhe sigurisë efektive.
15. Kurse në nenin 26 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 – Tekstet shkollore dhe mjetet e tjera mësimore përcakton në menyre të qartë: “me qëllim të sigurimit të cilësisë së materialeve që përdoren në institucionet publike arsimore dhe aftësuese, Ministria miraton tekstet shkollore dhe mjetet e matërialet tjera mësimore sipas këshillave të AKKSV-së, dhe sipas rregullave të prokurimit, hartimit, rishikimit dhe publikimit të cilat përcaktohen në një akt nënligjor...”⁸

Analiza e rastit

(a) Pësia e çantës

16. Çantën shkollore të një nxënësi e përbën objekti i saj dhe përmbajtja, e cila definohet si “trastë zakonisht katërkëndëshe prej lëkure, plastike, që mbyllet me dorezë ose rrip dhe që shërben për të mbajtur me vete libra e sende të tjera”⁹. Në Kosovë përdoren lloje të ndryshme çantash me përbërje nga plastika dhe me fije sintetike. Përmbajtja e brendshme është kryesisht me libra shkollor, fletore, fletore pune, lapsa të ndryshëm, ushqime dhe ndonjë mjet tjetër. Çanta boshe nuk ka ndonjë peshë që do të mund të llogaritej si faktor mbingarkese. Shumica e nxënësve çantën e bartin në shpinë.
17. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) pësia e çantës shkollore nuk duhet të tejkalojë 10 % e peshës trupore të nxënësit.¹⁰

⁷ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.14/17, korrik 2019, Prishtinë gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844.

⁸ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.17/16 Shtator 2011, Prishtinë <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>

⁹ Shih: <https://fjalorthi.com/%C3%A7ant%C3%AB>

¹⁰ <https://applications.emro.who.int/imemrf/568/J-Islamabad-Med-Dent-Coll-2021-10-1-358-364-eng.pdf>

18. Sipas një hulumtimi nga Instituti Ed Guard pesha e çantave të fëmijëve të ciklit fillor dhe të mesëm të ulët është mesatarisht 4.3 kg, dhe paraqet 14% e peshës së tyre të trupit, kundrejt 10% të normës së rekomanduar. Të gjeturat tregojnë që në veçanti fëmijët e ciklit fillor, të klasave 1-5, janë më të prekur, me peshën e çantës deri në 16% të peshës së trupit.¹¹
19. Nga matjet që disa komuna kanë bërë¹² rezulton se pesha e çantave të nxënësve të ciklit fillor klasat 1-5 me të gjithë librat dhe fletoret, varion nga 5 kilogram më e lehta deri në 6 kilogram më e rënda, ndërsa pesha mesatare e të gjithë çantave të këtij cikli është 5.6 kilogram.
20. Çantat e shkollës, nëse kanë një peshë të rëndë, krijojnë shtypje të vertebrave dhe kjo ndikon direkt në deformimin e shtyllës kurrizore sipas ekspertëve shëndetësor¹³. Çanta e mbingarkuar e nxënësve vjen si rezultat i teksteve të shumta shkollore dhe që janë të obligueshme. Numri i madh i teksteve pasi për një lëndë janë tri deri në katër libra dhe për një detyrë shtëpie nxënësit detyrohet të marrin shumë libra me veti. Po ashtu ekzistojnë studime¹⁴ që tregojnë se fëmijët më të vegjël kanë më shumë nevojë për edukim në lidhje me peshën e çantës së shkollës në krahasim me të rriturit. Ekzistojnë gjithashtu dëshmi se vajzat mund të kenë më shumë probleme kur mbajnë çantën e shkollës në krahasim me djemtë.
21. Sa i përket arsyeve të peshës së çantës, ka disa elemente që ndikojnë në peshën e saj, e kryesisht kanë të bëjnë me kurrikulën e paraparë për ciklin shkollor përkatës dhe ngarkesa me mjete tjera të shkollës të tilla si fletore, lapsa, vizore, ngjyra etj.
22. Sa i përket kurrikulës dhe sipas hulumtimeve nga Instituti Pedagogjik i Kosovës, me titull “Mbingarkesa Kurrikulare në Arsimin Fillor dhe të Mesëm të Ulët në Kosovë”¹⁵ theksohet në Përmbledhjen e karakteristikave të manifestimit të ndikimit të mbingarkesës kurrikulare në mirëqenien e nxënësve, se mes tjerash ndikon te nxënësit për “Lodhje dhe rraskapitje nga pesha e çantës;” Gjatë tekstit në mënyrë të përsëritur “ngarkesa e çantës” konsiderohet problematike edhe nga akterët e tjerë.
23. Po ashtu sipas punimit “Ngarkesa fizike e nxënësve në raport me peshën dhe moshën kalendarike të tyre”¹⁶ – theksohet se në Kosovë pa ndonjë analizë paraprake shtohet sasia e teksteve dhe mjeteve të tjera mësimore për nxënësit, nuk merret parasysh moshja dhe parametrat e tjerë antropometrik si dhe standardet fizioterapeutike për nivelin e peshës së lejuar për moshë të caktuar, nuk bëhet përcaktimi i një orari të strukturuar ashtu që në të njëjtën ditë nxënësit të mos kenë detyrime nga lëndë mësimore të ndryshme, nuk merret parasysh gjatësia e rrugës që bëjnë fëmijët në relacionin shtëpi-shkollë dhe anasjelltas.

¹¹<https://www.radiokosovaelire.com/instituti-edguard-ndikimi-peshes-se-cantave-te-femijet-ka-nxitur-debat-dhe-shqetesimin-e-prinderve/>

¹² Komuna e Junikut dhe Rahovecit

¹³ Shih artikullin në: <https://www.botasot.info/shendetesia/745136/canta-e-shkolles-si-ta-zgjedhim-qe-te-mos-demtoje-kurrizin-e-femijes/>

¹⁴ Shih Kellis, Eleftherios PhD; Emmanouilidou, Maria MSc, The Effects of Age and Gender on the Weight and Use of Schoolbags, Pediatric Physical Therapy 22(1):p 17-25, Spring 2010.

¹⁵ Shih Instituti Pedagogjik i Kosovës, “Mbingarkesa Kurrikulare në Arsimin Fillor dhe të Mesëm të Ulët në Kosovë, Prishtinë 2022, faqe 272 i qasshëm në: <https://ipkmasht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/12/Mbingarkesa-kurrikulare-ne-arsimin-fillor-dhe-te-mesem-te-ulet-ne-Kosove-realitet-apo-perceptim.pdf>

¹⁶ Ismet Potera, Ngarkesa fizike e nxënësve në raport me peshën dhe moshën kalendarike të tyre, 2011

(b) Gjatësia e rrugës që bëjnë fëmijët në relacionin shtëpi-shkollë dhe anasjelltas

24. “Hulumtimi nga Ed Guard citon se fëmijët kalojnë mesatarisht 10-15 minuta ecje nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas, dhe vetëm disa prej tyre, ndonjëherë ndihmohen në bartje të çantës, nga prindërit apo kujdestari”.¹⁷
25. Avokati i Popullit nga përgjigjet e marra nga komunat vëren se distanca e udhëtimit të nxënësve të ciklit fillor nga shtëpia deri në shkollë, ndryshon varësisht nga vendbanimi i nxënësve dhe vendndodhja e shkollave. Rezulton se nxënësit e ciklit fillor përshkojnë në këmbë udhëtimin shtëpi-shkollë dhe anasjelltas nga 200 metra¹⁸ gjatësia më e vogël, deri në 5 kilometra¹⁹ më e madhja, dhe në rastet e distancave me të largëta transportin e sigurojnë komunat.
26. Avokati i Popullit, pas vlerësimit të përgjigjeve nga komunat lidhur me kërkesën e Institucionit të Avokatit të Popullit për informata rreth *numrit të shkollave të ciklit fillor 1-5, të cilat janë të pajisura me dollapë funksionale për vendosjen e librave të nxënësve*, vëren se Komuna e Hanit të Elezit, Kaçanikut, Mamushës, Mitrovicës Veriore, Klllokotit dhe Obiliqit, ende nuk kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme për funksionalizimin e dollapeve në shkollat që veprojnë në kuadër të sistemit edukativo-arsimor.
27. Avokati i Popullit, në bazë të dokumentacionit që ka pranuar nga komunat, vëren se pesë komuna kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe kanë funksionalizuar dollapët në shkollat²⁰.
28. Ndërsa nga përgjigjet e marra nga komunat vërehet se 15²¹ prej tyre, pjesërisht janë të pajisura me dollape për vendosjen e librave nga nxënësit ose janë në proces e sipër për funksionalizim të tërësishëm.
29. Sipas KDF interesat më të mira të fëmijëve duhet të jenë në qendër të çdo vendimi që ndikon në mirëqenien e tyre. Megjithatë, pesha e rëndë e çantave shkollore që shumë fëmijë detyrohen të mbajnë çdo ditë bie ndesh me këtë parim themelor, duke rrezikuar shëndetin fizik dhe zhvillimin e tyre të përgjithshëm. Në këtë kuptim, mbajtja e çantave të rënda bie në kundërshtim me nenin 24 të KDF, i cili garanton të drejtën e fëmijës për të pasur një shëndet optimal dhe për të jetuar në kushte që promovojnë zhvillimin e tij të plotë. Po ashtu, neni 19 i KDF thekson detyrimin që fëmijët mes tjerash të mbrohen nga çdo formë e dhunës fizike, dhe mospërfilljeje.
30. Fëmijët që vuajnë nga dhimbje të vazhdueshme ose lodhje fizike shpesh përjetojnë stres dhe lodhje mendore. Kjo mund të ndikojë negativisht në përqendrimin e tyre në mësim, në motivimin për të ndjekur shkollën dhe në aftësinë për të shijuar procesin mësimor. Sipas Dr. Remzi Shalës, specialist i mjekësisë familjare dhe shef në QKMF Fushë Kosovë, mbingarkesa e çantave është një problem mjaft shqetësues i cili ndikon në sjelljen agresive jonormale të fëmijëve. “Mbingarkesa e çantave është një problem i cili në mënyrë të tërthortë apo në shumicën e rasteve në mënyrë të drejtëpërdrejtë ndikon

¹⁷ Facebook-Instituti Ed Guard-Hulumtim mbi peshën e çantave

¹⁸ Komuna Rahovec

¹⁹ Komuna Klinë, Mitrovicë dhe Suharekë

²⁰ Komuna Drenas, Gjakovë, Gjiilan, Junik dhe Zveçan

²¹ Komuna Deçan, Dragash, Ferizaj, Graçanicë, Klinë, Lipjan, Mitrovicë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtërpçë, Shtime, Suharekë, Viti.

edhe në sjelljen e fëmijëve që ata të kenë një sjellje agresive dhe sjellje jo normale për moshën e fëmijëve”.²² Në këtë kontekst, pesha e çantave shkollore bëhet një pengesë për përmbushjen e së drejtës së fëmijëve për arsimim cilësor dhe për të arritur potencialin e tyre të plotë, ashtu siç theksohet në nenin 28 të KDF.

31. Sipas IOWA Health Care (një sistem shëndetësor në shtetin e Iowa, SHBA, që përfshin një rrjetë të gjerë spitalesh, klinikash, dhe profesionistësh të kujdesit shëndetësor), e që ndër të tjera merret edhe me hulumtime mjekësore, është realizuar një hulumtim mbi peshën e çantave të shkollës, përfshirë ato nga University of Iowa Health Care, që tregon se mbajtja e një çante të rëndë mund të shkaktojë probleme të shumta shëndetësore tek fëmijët dhe të rinjtë. Ky hulumtim në fokus të veçantë tregon se mbajtja e ngarkesave të rënda mund të ndikojë negativisht në zhvillimin kockor të fëmijëve dhe të rrisë rrezikun për dëmtime në gjymtyrët e poshtme dhe shpinë gjatë rritjes²³.
32. Përveç efekteve shëndetësore dhe arsimore, çështja e çantave të rënda mund të shihet si një shkelje e të drejtës së fëmijëve për një fëmijëri të gëzuar dhe të lirë nga dëmtimet e parandalueshme. Sipas nenit 31 të Konventës, fëmijët kanë të drejtë për pushim dhe lojë, dhe çdo barrë e panevojshme që pengon lirinë e tyre për të marrë pjesë në aktivitete argëtuese bie ndesh me këtë të drejtë. Fëmijët që detyrohen të mbajnë çanta të rënda mund të ndihen të lodhur pas orëve të mësimi, duke kufizuar pjesëmarrjen e tyre në lojëra ose aktivitete të tjera jashtëshkollore, që janë të rëndësishme për zhvillimin e tyre emocional dhe social.
33. Në përputhje me LMF, çdo vendim dhe veprim që prek fëmijët duhet të bazohet në interesin e tyre më të mirë, duke siguruar që ata të kenë kushte për një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor dhe emocional. Pesha e çantave shkollore që shumë fëmijë të shkollës fillore detyrohen të mbajnë çdo ditë bie ndesh me këto parime dhe përbën një sfidë serioze për të drejtat e tyre. Për të mbrojtur mirëqenien e fëmijëve, është e nevojshme që shkollat dhe autoritetet arsimore të ndërmarrin masa të menjëhershme për të reduktuar peshën e çantave dhe për të krijuar një mjedis më të sigurt dhe më të shëndetshëm për të gjithë fëmijët.
34. Sipas LMF komunat kanë një rol kyç në parandalimin dhe reduktimin e faktorëve që mund të vënë në rrezik jetën dhe mirëqenien e fëmijëve. Roli i komunave përfshin një sërë detyrimesh dhe përgjegjësisht specifikë që synojnë krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të favorshëm për zhvillimin e fëmijëve. Ligji gjithashtu përcakton se komunat duhet të zhvillojnë dhe zbatojnë plane strategjike për mbrojtjen e fëmijëve, duke përfshirë masa konkrete për identifikimin dhe eliminimin e rreziqeve që mund të dëmtojnë jetën dhe mirëqenien e tyre.²⁴ Këto plane duhet të jenë në përputhje me politikat kombëtare dhe të bazohen në interesin më të mirë të fëmijës.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

35. Avokati i Popullit konstaton se pesha e çantës shkollore të nxënësve të ciklit fillor, e cila fillon nga 5 kg deri në 6 kg, sipas gjetjeve nga ekspertët shëndetësorë shkakton mbingarkesë fizike të nxënësit duke krijuar dëmtime në shtyllë kurrizore. Përveç efekteve

²² <https://kallxo.com/gjate/hulumtim/cantat-e-renda-problem-serioz-per-shendetin-e-nxenesve/>

²³ <https://uihc.org/health-topics/your-backpack-too-heavy>

²⁴ Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, neni 14 paragrafi 8

shëndetësore dhe arsimore, çantat e rënda mund të shihen si një shkelje e të drejtës së fëmijëve për një fëmijëri të gëzuar dhe të lirë nga dëmtimet e parandalueshme.

36. Nga konstatimet në këtë raport, Avokati i Popullit sjell në vëmendje rëndësinë e funksionalizimit të dollapëve në shkolla të cilët do ndikojë pozitivisht për të parandaluar mbingarkesën fizike e cila vjen nga pesha e çantave, sepse të njëjtit dollap do përdoren për mbajtjen e librave në to. Avokati i Popullit rithekson se nga përgjigjet e marra nga disa nga komunat, shkollat janë pjesërisht të pajisura me dollapë për vendosjen e librave nga nxënësit ose janë në proces e sipër për funksionalizim të tërësishëm, përderisa ka edhe komuna që nuk janë të pajisura me dollapë.
37. Avokati i Popullit po ashtu konstaton se mbingarkesa kurrikulare në arsimin fillor, ndikon në mirëqenien e nxënësve, se mes tjerash ndikon te nxënësit për lodhje dhe rraskapitje nga pesha e çantës. Pas rishikimit të legjislacionit përkatës, të instrumenteve ndërkombëtare, të dokumentacionit të çështjes, të informatave dhe të të dhënave që Institucioni i Avokatit të Popullit i ka në dispozicion, del se në rastin konkret ka shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, përkatësisht të të drejtave të fëmijëve, pasi autoritetet përkatëse nuk i kanë përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore e as standardet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës, duke mos marrë parasysh ndikimin negativ që ka bartja e peshave të rënda për fëmijët e kësaj moshe.
38. Për zvogëlimin apo zbutjen e këtij problemi duhen të ndërmerren hapa bashkëpunimi ndërmjet institucioneve shtetërore dhe aktereve të tjerë të cilët ndërlidhen me këtë çështje me qëllim që të evitohet ngarkesa fizike e nxënësve.

Prandaj Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që mësimdhënësit të trajnohen për zbatim efikas të planprogramit gjatë orëve mësimore, të reduktojnë detyrat e shtëpisë, të rishikohet mbarëvajtja e aktiviteteve gjatë orëve të edukatës fizike.

Komunës së Deçanit

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Dragashit

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Fushë Kosovës

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Ferizajt

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Graçanicës

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Hanit të Elezit

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Istogut

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Kaçanikut

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Kamenicës

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Klinës

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Klllokotit

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Lipjanit

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Malishevës

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Mamushës

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Mitrovicës së Jugut

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Novobërdës

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Obiliqit

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Parteshit

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Pejës

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Podujevës

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Prishtinës

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Prizrenit

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Rahovecit

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Ranillgut

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Shtërpcës

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Shtimes

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Skenderajt

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Therandës

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Vitisë

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Vushtrrisë

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Mitrovicës së Veriut

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Zubin Potokut

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Zveçanit


- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Komunës së Leposaviqit

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e dollapëve nëpër shkolla në mënyrë që tekstet të lihen në shkollë.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe në pajtim me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,


Naim Qelaj

Avokat i Popullit